



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 15.07.2026

Drejtuar: UDHA sh.p.k

Operatorit Ekonomik (OE) X ose

“UDHA” sh.p.k me NUIS: K77524909Q

Adresa: “Diber Burrel Burrel, Lagjja “Pjeter Budi”, Rruga “Qamil Xhika”, Ndertesa
Nr.31 8001.”

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur - Punë

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-90779-06-22-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Heqje dhe furnizim-vendosje dritare dhe dyer
duralumini Godina e Paraklinikut”**, me fond limit 25,199,961.58 (njëzet e pesë milion e

njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e tetë)
lekë pa TVSH.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 23.06.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 41 datë 29 Qershor 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “UDHA” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K77524909Q
Numri i NIPT-it

Vlera **24,235,223** [njëzet e katër milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet e tre] lekë pa TVSH
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “DRINI-1” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

J78716317H
Numri i NIPT-it

Vlera **24,826,755** [njëzet e katër milion e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë] lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “DRINI-1” sh.p.k me NIPT J78716317H si më poshtë:

- **Tek kriteret e veçanta pika 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Punonjes për dyer dritare PVC	10
Bojaxhi	2
Suvatues	2
Shofer	3
Automakinista	2

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas DST pasi nuk ka paraqitur të plotë stafin e kërkuar. Konkretisht stafi i paqitur sipas tabelës si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Punonjes për dyer dritare PVC	0
Bojaxhi	1
Suvatues	0
Shofer	2
Automakinista	0

Operatori ekonomik “DRINI-1” sh.p.k me NIPT J78716317H nuk plotëson pikën 2.3.5 sipas DST.

- **Tek kriteret e veçanta pika 2.3.6** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të tij si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:
b) 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë “Specialist për punimet në lartësi”, sipas V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas DST pasi nuk ka paraqitur të plotë stafin e kërkuar konkretisht për pikën b) të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë punonjës.

- **Tek kriteret e veçanta pika 2.3.7/a** Për të mundur verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues, për

materialet: dritare dhe dyer prej duralumini dhe/ose plastike, xhama, duhet të paraqesë katalogët ose fragmente të katalogëve të prodhuesit/distributorit zyrtar, ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/distributori zyrtar, ku të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Katalogët ose skedat teknike duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të materialeve, në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë nëse materialet e ofruara, të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së punimeve/shërbimeve, përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Katalogët ose skedat teknike duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas DST pasi nuk ka paraqitur katalogun ne dokumentat e paraqitura në sistemin elektronik të APP-së

- **Tek kriteret e veçanta pika 2.3.7/b** Operatori ekonomik ofertues, për materialet: **dritare dhe dyer prej duralumini dhe/ose plastike, xhama,** të cilat do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës dhe për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë **autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar.**

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas DST pasi nuk ka paraqitur asnjë document për këtë kriter në dokumentat e paraqitura në sistemin elektronik të APP-së.

- **Tek kriteret e veçanta pika 2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te disponoje:** Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.9 sipas DST pasi nuk ka paraqitur licencë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B”.

- **Tek kriteret e veçanta 2.3.10** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht sipas tabelës te paraqitur në DST.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas DST pasi nuk ka paraqitur të plotë listën e makinerive të kërkuar në DST.

Referuar çfarë është cituar më lart operatori ekonomik “DRINI-I” sh.p.k me NIPT J78716317H nuk kualifikohet pasi nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “UDHA” sh.p.k me NIPT K77524909Q dhe Adres: Diber Burrel Burrel, Lagjja “Pjeter Budi”, Rruga “Qamil Xhika”, Ndertesa Nr.31 8001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **24,235,223** [njetet e kater milion e dyqind e tridhjetë e pese mije e dyqind e njetet e tre] lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR